



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**

**Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së gjashtë - VI - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 28.06.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

**Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës:** Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Ilir Hasani, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Graçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

**Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtive të Komunës:** Fadil Krasniqi - Nënkyrytar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtore i Financave dhe Buxhetit, Ekrem Berjani - Drejtore i Zhvillimit Ekonomik, Lindita Rrahmani Jashanica - Drejtoreshë e Arsimit, Fatlum Berisha - Udhëheqës i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Besnik Hykoli - Udhëheqës i Drejtorisë së Inspektoratit.

**Të tjerë:** Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshtëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

**REND DITE**

1. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për emërtimin e Shkollës Filliore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë.
4. Propozim për emërtimin e Shkollës Filliore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë.
5. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për mësimin joformal.
6. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërim shëndetësorë për Rajana Berisha.
7. Propozim për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Filliore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë.
8. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova'.
9. Propozim për lirimin e subjekteve afariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës.
10. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

**Ilir Hasani:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një propozim që tek ‘Rregullorja për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale’, ta ndryshojmë një nen dhe ta marrim një vendim me karakter të përkohshëm për lirimin nga pagesa të bizneseve tona, që paguajnë për një orë punë pas orës 23:00h shumën e mjeteve financiare prej: 25.00€, e cila shumë në këtë kohë të pandemisë është e lartë, meqë bizneset kanë shumë vështirësi, në operimin e tyre ekonomikë dhe asaristë, andaj në fillim të sezonës së pushimeve dhe ardhjes së mërgimtarëve, ne duhet t'i përkrahim, ne kërkojmë që ky vendim të ketë validitetin e tij, nga data 01 korrik deri me 31 dhjetor 2021.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për këtë mbledhje me pikën shtesë: ‘Propozimin për lirimin e subjekteve asariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar, me pikën shtesë: ‘Propozimin për lirimin e subjekteve asariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës’.

#### **Pika e parë (1) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim, ‘Propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024’, stoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

**Drejtori për Financa dhe Buxhet:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024, është hartuar në përputhje me kusjtë buxhetorë të caktuar me Qarkoren Buxhetore numër 2, supozohet se do të ketë edhe një Qarkore Buxhetore numër 3, ne si Drejtori e Financave dhe Buxhetit, e kemi bërë shpërndarjen e dokumentit bazikë të buxhetit nëpër Drejtoritë e Komunës dhe njësítë tjera organizative me datën 08.06.2021, për t'i dhënë vlerësimet e herëshme, numrin e të punësuarëve, shpenzimet nëpër kategoritë ekonomike dhe caktimin e prioriteteve për projektet kapitale publike, për vitin 2022 dhe vlerësimet e herëshme për vitet 2023 dhe 2024. Në fund të projekt-dokumetit për buxhetin, i keni edhe datat e parapara për tre dëgjime publike për projekt-buxhetin e vitit 2022, në tabelën numër 2 sqarohen grantet e qeverisë dhe të hyrat vetjake, granti i përgjithshëm qeveritarë për administratë dhe drejtoritë dhe njësítë tjera organizative të komunës, është në shumë të mjeteve financiare prej: 3,736,842.00€, granti qeveritarë për arsim është në shumë të mjeteve financiare prej: 3,746,942.00€, granti qeveritarë për shëndetësi është në shumë të mjeteve financiare prej: 1,251,487.00€ dhe granti qeveritarë për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim është në shumë të mjeteve financiare prej: 39,918.13€. Buxheti i komunës për vitin 2022 është në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej: 11,656,080.00€, që krahasuar me buxhetin e vitit 2021, është më i madh për shumën e mjeteve financiare prej: 663,394.00€. Në tabelën numër 3 është parashikimi i të hyrave buxhetore komunale për vitet 2022-2024 me grantin qeveritarë në shumën e mjeteve financiare prej:

8,735,271.00€, në tabelen numër 4 paraqitet struktura e shpenzimeve në nivel të gjithë Kosovës, në tabelën numër 5 është buxheti i shpërndarë nëpër Drejtoritë e Komunës dhe numri i të punësuarëve, i cili parashihet të jetë më i madh për 52 punëtorë. Buxheti i komunës i shpërndarë nëpër kategori ekonomike të shpenzimeve është si vijon: për paga dhe mëditje është në shumë të mjeteve financiare prej: 5,297,346.00€, për malléra dhe shërbime është në shumë të mjeteve financiare prej: 1,831,203.00€, për shpenzime komunale është në shumë të mjeteve financiare prej: 260,000.00€, për subvencione dhe transfere është në shumë të mjeteve financiare prej: 387,000.00€ dhe në fund për projekte kapitale është në shumë të mjeteve financiare prej: 3,880,531.00€. Tabela ku janë të paraqitura projektet kapitale financohet nga granti qeveritarë dhe të hyrat vetjake, të cilat janë në shumë të mjeteve financiare prej: 2,920,000.00€. Në tabelën 4.2 janë të radhituar projektet kapitale të mbështetura në kërkesat e qytetarëve të paraqitura nëpër Drejtoritë e Komunës, të cilat nëse kanë arsyeshmëri propozimet e caktuara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës mund të ndryshohen.

**Durim Hajra:** Përvendoset një analizë e buxhetit të vitit 2022-2024, përfshirë qytetet e qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Buxheti nuk i ka tani nëntë objektiva, po tetë, prej tyre katër nuk janë përmbrushur asnjëherë dhe Komuna e Fushë-Kosovës në këto fusha është shumë keqë. Këtu çështja e parë që dua ta ngriti për shqyrtim, është mbrojtja e ambientit, ku mjeshtëri i komunës tonë është shumë i ndotur dhe paraqetë një burim të infeksionit në këtë kohë të vështirë të pandemisë, e në anën tjetër kërkesat e qytetarëve sipas Ekzekutivit të Komunës për asfaltimë dhe zhavor janë shumë të mëdha, ne kërkesat e qytetarëve do t'i paraqesim edhe gjatë dëgjimeve buxhetore në muajin korrik dhe gusht, sepse ne e kemi evidentuar gjendjen dhe nevojat në teren. Shtëpia e Kulturës ka nevojë për renovim të thellë, aty nuk ka kushte për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, nuk ka asnjë projekt publik për përkrahjen e të rinjëve, për uljen e nivelit të lartë të papunësisë. Në kohë kur nevojat përfshirin publike dhe rregullimin e shërbimeve në arsim dhe shëndetësi janë shumë të mëdha, parashihen investime publike në asfaltimë në shumë të mjeteve financiare prej gjysëm milioni euro dhe përfshirin publik për zhavor njëqindëmijë euro, pastaj shumë e mjeteve financiare përfshirin vendime gjyqësore. Tani kur janë rritur kërkesat përfshirë shërbimeve në shëndetësi, por edhe në arsim në komunën tonë përsëri arsyecitë të rrëthanave të ditura, përfshirë numrin e madh të nxënësve në qytet, në komunikimin ndërmjet nivelit qendrorë dhe nivelit lokal ekziston një boshllék i madh, në adresimin e çështjeve jetikë përfshirë qytetarë. Ne kërkojmë që të organizohen më shumë dëgjime publike përfshirë projekt-buxhetin e vitit 2022, jo vetëm tre siç mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës, por ato të mbahen edhe nëpër fshatra dhe nëpër lagje të qytetetit, ku qytetarët do t'i paraqesin nevojat e tyre përfshirë investime në zonat e tyre të banimit.

**Mehdi Lahu:** Përvendoset një analizë e buxhetit të vitit 2022-2024, përfshirë qytetet e qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës. Buxheti nuk i ka tani nëntë objektiva, po tetë, prej tyre katër nuk janë përmbrushur asnjëherë dhe Komuna e Fushë-Kosovës në këto fusha është shumë keqë. Këtu çështja e parë që dua ta ngriti për shqyrtim, është mbrojtja e ambientit, ku mjeshtëri i komunës tonë është shumë i ndotur dhe paraqetë një burim të infeksionit në këtë kohë të vështirë të pandemisë, e në anën tjetër kërkesat e qytetarëve sipas Ekzekutivit të Komunës përfshirin publike dhe zhavor janë shumë të mëdha, ne kërkesat e qytetarëve do t'i paraqesim edhe gjatë dëgjimeve buxhetore në muajin korrik dhe gusht, sepse ne e kemi evidentuar gjendjen dhe nevojat në teren. Shtëpia e Kulturës ka nevojë për renovim të thellë, aty nuk ka kushte përfshirë zhvillimin e aktiviteteve kulturore, nuk ka asnjë projekt publik përfshirë përkrahjen e të rinjëve, përfshirë uljen e nivelit të lartë të papunësisë. Në kohë kur nevojat përfshirin publike dhe rregullimin e shërbimeve në arsim dhe shëndetësi janë shumë të mëdha, parashihen investime publike në asfaltimë në shumë të mjeteve financiare prej gjysëm milioni euro dhe përfshirin publik përfshirë zhavor njëqindëmijë euro, pastaj shumë e mjeteve financiare përfshirin vendime gjyqësore. Tani kur janë rritur kërkesat përfshirë shërbimeve në shëndetësi, por edhe në arsim në komunën tonë përsëri arsyecitë të rrëthanave të ditura, përfshirë numrin e madh të nxënësve në qytet, në komunikimin ndërmjet nivelit qendrorë dhe nivelit lokal ekziston një boshllék i madh, në adresimin e çështjeve jetikë përfshirë qytetarë. Ne kërkojmë që të organizohen më shumë dëgjime publike përfshirë projekt-buxhetin e vitit 2022, jo vetëm tre siç mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës, por ato të mbahen edhe nëpër fshatra dhe nëpër lagje të qytetetit, ku qytetarët do t'i paraqesin nevojat e tyre përfshirë investime në zonat e tyre të banimit.

banorëve, që ne kemi problem me regjistrimin e popullsisë në aspektin formal, por sipas numrit të nxënësve, që në komunën tonë është në rritje nga viti në vitë. Mënyra tjetër e veprimit që duhet të mirret në konsideratë nga Drejtoria e Arsimit, është dërgimi i mësuesve të fshatrave, ku është numri i vogël i nxënësve në shkollat e qytetit.

**Naser Graçevci:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Përgatitja e buxhetit të komunës dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore për njëzet vjetë me radhë, po thuaj se, është e ngjajshme, me ndryshime shumë të vogla, pa asnjë ndryshim substanciale dhë që vlenë të përmendet. Në qytet ka shumë probleme, është një kallaballëkë shumë i madh i njerëzve në zona të caktuara. Unë pyes, a keni menduar për lirimin e trafikut me rrugë njëkahore apo mbyllje të rrugëve për qarkullim në kohë të caktuar? Ne në muajin prill në Kuvendin e Komunës jemi informuar për ‘Planin e mobilitetit në trafik’, por në buxhet për vitin e ardhshëm nuk parashihet asgjë. Në bujqësi nuk ka asnjë ndryshim, për ruajtjen e produkteve të fermerëve tanë, sikur po shihet Ekzekutivi I Komunës po vazhdon njësoi, pa asnjë analizë apo studim të ndikimit të projekteve publike, njëjtë, ka shumë asfaltime vend e pa vend, të cilat prehen për secilën shërbim publik të mëvonshëm dhe nuk rregullohen, në qytet nuk parashihet askund ndonjë vend për rekreacion, vendëpushime për të moshuarit nënat lehon, fëmijët mund të bëhen edhe në hapësira të vogla, por nuk po ka asnjë ide kreative për projekte të reja, nuk ka asnjë projekt përbajtësorë të realizuar nga komuna, si duket jeni lodhur nga pushteti. Ne mendojmë se diçka mund të bëhet në zonën e hirit, gjithmonë është një zë buxhetor për parqe dhe kënde të lojërave, por investime cilësore nuk ka askund. Buxhet për rini të sportit për aktivitetet e tyre nuk ka, me përjashtim të subvencioneve në shuma të vogla për klube sportive, ne mendojmë se aktivitetet e rinisë dhe sportistëve duhet të përkrahen më projekte adekuate nga komuna. Ka mundësi që kjo mënyrë jo e mirë e hartimit të buxhetit, të njallet përmes debateve publike nëpër lagje të qytetit e fshatra, me takime direkte me qytetarë.

**Aida Alimi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Propozimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024, është një pëershkrim i njëjtë i projekteve publike, ne kemi kërkuar që në arsim të krijohen klasat për parashkollarë në qytetin e Fushë-Kosovës, nga fillimi i mandatit tonë para katër viteve, por kjo nuk ka ndodhur, kemi kërkuar që të bëhet një regjistrimi i brendshëm i popullsisë për nevojat e komunës, si formë e presionit publik për shtimin e fondeve publike për arsim dhe shëndetësi, ku kemi probleme të mëdha. Keni dështuar po ashtu në rregullimin e planifikuar të sheshit në rrugën e ‘Dardanisë’, nga Drejtoria e Planifikimit Urban, propozohen vetëm asfaltime të pjesëshme të rrugëve, të cilët po dëmtohen menjëherë brenda një viti.

**Driton Ademi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Problemet ne sektorë të ndryshëm të komunës, këtu në Kuvendin e Komunës duhet të fliten në gjuhën financiare, që ato të kornizohën për zhvillim në tre vitet e ardhshme, përmes Kornizës Afatmesme Buxhetore, ku qartësohen zhvillimet e bazamentit të dokumentit buxhetor në aspektin kohor, përmes dëgjimeve publike për buxhetin, ku qytetarët flasin dhe shprehin nevojat e tyre për investime publike të komunës në fshatra dhe lagje të qytetit, sepse ata i njohin më së miri problemet, me të cilat ballafaqohen çdo ditë. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024, pëershkruehen projektet për infrastrukturë publike, projektet në arsim, shëndetësi, kulturë e sport, të cilave ne duhet t'i japim përkrahje përmes dëgjimeve publike për buxhetin e vitit të ardhshëm.

**Mirvete Gërguri:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në propozimin për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024, tani unë pyes, sa ura parashihet të ndërtohen në vitin 2022?. Ne nuk po shohim asnjë specifikim konkret në kodin e caktuar për urat, nevoja për ndërtimin e urës kryesore në lumin ‘Drenica’ në fshatin Bardh i Madh është evidente, sepse ura e ndërtuar nga fshatarët para shumë viteve, është shumë e dëmtuar tani dhe paraqet një vend me rrezik për traktorët e fshatarëve, njerëzve dhe bagëtisë që kalojnë nëpër këtë urë dhe mund të pësojnë në të ardhmen. Për këto qëllime janë planifikuar vetëm shtatëdhjetë mijë euro dhe njëqind e tridhjetë e tetë mijë euro, këto shuma janë të pamjaftueshme, planifikimi nuk është realë, ne që në planifikim kemi dështuar.

**Nënkyetari i Komunës:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Dua të ju sqaroi të gjithë juve, se këto propozime të paraqitura në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024, janë përgatitur nga Drejtori i Komunës, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve të komunës, të paraqitura nëpër secilën drejtori për projekte publike të fushave të ndryshme. Ne kemi projekte edhe për mbrojtjen e ambientit, edhe për sportin, ju e dini se klubet sportive ndihmohen me subvencione nga komuna në secilin viti, po ashtu kemi punuar shumë në krijuimin e një ambienti të mirë në parkun e pishave në fshatin Sllatinë e Vogël, duke e rregulluar infrastrukturën atje, e kemi edhe një park të vogël në oborrin e shkollës ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë, po ashtu duhet ta cekim se vitin e kaluar i kemi ndihmuar edhe bizneset e komunës. Në arsim kemi probleme me numrin e punëtorëve, vetëm tani na duhen së paku edhe pesëdhjetë punëtorë të rinjë, ju po i shihni në buxhet, kërkesat tona për 52 punëtorë të ri, në arsim dhe shëndetësi, këto kërkesa ne i kemi përsëritur disa herë edhe nga Drejtori përkatëse për Ministinë e Arsimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë, ne këtu vazhdimishtë e kemi kërkuar edhe ndihmën e juve si përfaqësues të opozitës nëpër ministri të linjës, sepse për arsimin dhe shëndetësinë në komunën tonë nuk duhet të kemi ndarje. Tek hiri është një projekt i përbashkët me Bankën Botërore dhe Bashkimin Evropian, ata janë duke e përgatituar vetë projektin ideorë e zbatues, si dhe vetë do ta financojnë këtë projekt publikë, i cili do të jetë i mirë se ardhur për banorët e qytetit tonë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024’.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota ‘për’, pesë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej të pranishëm njëzet e dy anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2022-2024’ dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
  - 1.1 Për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,656,080.00€;
  - 1.2 Për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,176,483.00€;
  - 1.3 Për vitin 2024 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,748,639.00€.

## Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën ‘Pjetje dhe përgjigje parlamentare’, sto anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

**Durim Hajra:** Unë do ta paraqes në vazhdim disa pyetje, të cilat jemi të detyruar edhe t'i përsërisim, për arsy se nuk po marrim përgjigje. Një problem është në rrugën e quajtur ‘Gurët e Gjatë’ në fshatin Harilaç, ku është krijuar një deponi e egër aty dhe rruga është e pakalueshme, sepse është nën nivelin e tokës, banorët e lagjës e dijnë për cilin degëzim po flasim këtu. Kemi kërkesa nga qytetarët ta dijmë, edhe kur do të fillon rregullimi i rrugës kryesore në fshatin Miradi e Epërmë, sepse do të ketë edhe organizime tjera, protesta të qytetarëve, na tregoni deri ku ka shkuar procedura në rastin konkret. Pyetja tjetër ka të bëjë, me listën e përfituesve të vërvshimeve, sepse disa qytetarë të prekuar nga vërvshimet në muajin janar 2021, ende nuk i kanë marrë mjetet financiare si kompensim për vërvshime. Në shkollën ‘Mihal Grameno’ janë mbjellur lule të cilat janë hequr nga vazot, ne pyesim, pse po blihen këto lule industriale, të cilat janë të kushtueshme, ne duhet të kemi kujdes edhe kur e shpenzojmë buxhetin e komunës. Personeli mjekësorë ka filluar të largohet dhe në këtë kohë kur pandemia, ende nuk ka përfunduar, mund të kemi shumë telashe, nëse nuk veprojmë në kordinim me Ministrinë e Shëndetësisë. Në fushën e mjedisit po ndodh një degradim i plotë, me ndërtime ilegale në zonën e pishave në fshatrat Sllatinë e Vogël dhe Poimozotin, ju vetë keni thënë se do të veprojmë për mbrojtjen e parkut tonë, por edhe keni konstatuar, se do të veproni njësori, ashtu si ka vepruar niveli qendrorë me rastin e ndërtimeve ilegale në Prevallë.

**Migjen Kolshi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sa për informimin e juaj z. Durim Hajra, ajo rrugë është në lagjen Rrafshinat, ka qenë në buxhet por nuk është realizuar, na është thënë se kjo hyn me asfaltimet në fshatin Sllatinë e Madhe, po ashtu unë kam kërkuar që të realizohet edhe projekti publik për rrëthimin e varrezave në fshatin Harilaç, por as kjo punë nuk është kryerë. Ne e përshëndesim Drejtoreshën e re të Arsimit, e kuptojmë që është në fillim dhe nuk kërkojmë tani llogari, por ne kërkojmë që shkollat tona në të ardhmen, të mos mbesin gjashtë muaj pa arsimtarë të Gjuhës Angleze si në të kaluarën. Nga Drejtoria e Inspektoratit, kërkojmë ta dijmë cilat janë masat e ndërmarra për ndërtimet, që janë duke u realizuar në parkun e pishave në fshatin Sllatinë e Vogël?

**Sabit Bullatovci:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë jam jashtëzakonisht i shqetësuar, me pushtetin e Lëvizjes Vetëvendosje në nivelin qendrorë dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës këtu, sepse në tre muajt e fundit janë njëzet e pesë persona të prekur me Covid - 19 në fshatin tim, ne si komunë i kemi rrëth gjashtëdhjetë mijë banorë, ndërsa në Palestrën e Sportit në fshatin tim në Miradi të Poshtme, jipen vetëm 24 vaksina në ditë, kjo është tallje me sëmundjen, ju të Vetëvendosjes dëgjoni, sepse u talleshi me qeverinë në të kaluarën, duke e quajtur Qeveria Koti, ndërsa tani nuk ka asnjë veprim nga kjo qeveri, kjo është një dhimbje shpirtërore për popullin tonë, popullata jonë janë është mashtruar keqë se kjo qeveri do t'i zgjedhë këto probleme. Të gjithë duhet të vaksinohen edhe Kryetari i Komunës, edhe Presidentja e Kosovës, ku është tani Arben Vitia, nuk ka asnjë apel dhe njoftim për vaksinim nëpër lagjet dhe fshatrat tona, praktika e njëjtë është në gjithë Kosovën, nga kjo sjellje e pa përgjegjëshme do të pësojmë të gjithë. Kjo sëmundje

ngjitëse nuk pyet deri tani ua ka marrë jetën 2300 qytetarëve të Kosovës, ju e keni marrë pushtetin me 50.02% duhet të vepronit tani. Ju tani i nderuarit Nënkyrytar i Komunës në ditë janë administruar vetëm 24 vaksina, kjo është një dhimbje shpirtërore dhe morale, duhet të gjinden format e veprimit, rinia janë është e mashtruar, kjo sëmundje ngjitetë kërkon veprime konkrete në secilën kohë.

**Mehdi Lahu:** Tani duhet të shtohen kapacitetet tona në Drejtorinë e Administratës, sepse vijnë mërgimtarët dhe kërkesa për certifikata të lindjes dhe shërbime tjera rritet.

**Ali Ismaili:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me përgjigjet që i marrim ne këtu në Kuvendin e Komunës nga përfaqësuesit e Ekzekutivit të Komunës, ne jemi bërë si rubrika 'Hajt pak' e KTV-së, pa përgjigje substanciale dhe reale për çështjet e ngritura për zgjidhje. Unë e pyes Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës, cilat janë veprimet e Inspektorëve të Ndërtimit për parandalimin e ndërtimeve të pa rregullta në parkun e pishave. A kanë leje të ndërtimit këta persona që po ndërtojnë atje objekte të ndryshme? Këto ndërtime e kanë degraduar zonën në fjalë, apo nuk mund të vepronit se këta njerëz janë të fuqishëm. Rregullimi i shiritave për çiklistë në të dy anët e rrugëve ndihmëse në qytet, është kryerë keqë, pa standarde dhe paraqet rrezik për njerëzit. Ne si institucion më i lartë përfaqësues i komunës, kërkojmë ta dijmë kush është Drejtoresha e re e Arsimit, ne e kuptojmë se kush ka vendosur, por kërkojmë të jemi të informuar. Për tetë vite në dy mandate që unë jam në Kuvendin e Komunës, për çdo vitë janë ndarë mjete financiare për vendosjen e kamerave nëpër shkolla dhe janë ndarë gjysëm milion euro, ndërsa kamerat janë vendosur vetëm në dy shkolla të qytetit 'Selman Riza' dhe 'Mihal Grameno', ne kërkojmë përgjigje të qartë për këtë punë, sepse edhe këtë vitë përvendosjen e kamerave i kemi të ndarë shumën e mjeteve financiare prej: 40,000.00€. Pastaj ndahen nga 500.00€ dhe 1,000.00€ për eskurzione të shkollave, pyes cilat janë kriteret për ndarjen e këtyre mjeteve financiare, a caktohen ato nga Drejtoria e Arsimit apo veprohet aty për aty 'ad hoc'. Po përfundon mandati zgjedhor dhe mikrofonat në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës nuk janë rregulluar ende, kjo punë nuk don komentë.

**Eglantina Azemi:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në lagjen e Dardanisë hapësirat publike nuk janë të rregulluara, mungon infrastruktura funksionale për qytetarë, nga lokalet asariste janë të uzurpuara së paku dhjetë parkingje, aty vendosen mysafirët e lokaleve asariste. Marrë në tërësi komuna i ka dëmtuar shumë parqet dhe hapësirat e lira publike, me veprimet dhe mosveprimet e sajë në shumë raste. Ne kërkojmë edhe vendosjen e kamerave në vendet kryesore të qytetit, nëpër vende të mira përvëzgimin e dukurive negative.

**Driton Hasoli:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Rregullimi i urës në fshatin Bardh i Madh ka qenë i planifikuar në buxhetin e vitit 2019, por kjo punë nuk është kryerë asnjëherë, unë kam kërkuar disa herë në Kuvendin e Komunës, rregullimin e urës qendrore të fshatit Bardh i Madh. Kjo urë paraqet rrezik për kalimin e njerëzve, e sidomos të fëmijëve tanë, andaj është në përgjegjësinë e komunës, që ta bëjë renovimin e kësaj ure, sa më shpejtë që të jetë e mundur. Po ashtu kërkesë tjetër që dua ta parashtroi për zgjidhje, është prerja e barit anash rrugës në relacionin Bardh i Madh/Lismir dhe Kuzmin/Bardh i Madh, sepse paraqet rrezik për zhvillimin normal të komunikacionit. Unë dua ta theksoi se në opinion po flitet shumë, se Ekzekutivi i Komunës është i korruptuar, fjalët për këtë fenomen janë maksimale në opinion, unë nuk kam fakte.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Duhet ta keni parasysh dhe kujdes se çfarë po fliteni, nuk është etike që fjalët e kujt do qoftë t'i fisisni këtu pa fakte konkrete, këtu nuk është vendi, kush dinë diçka dihet ku është adresa e lajmërimit.

**Ali Ismaili:** Të nderuarë nesër kemi informata, se do të bllokohet rruga Fushë-Kosovë/Prishtinë nga banorët e fshatit Miradi e Epërme, andaj kërkojmë ta dijmë deri ku kanë arritur procedurat gjyqësore, lidhur me padinë e Hekurudhës përrrugën kryesore në fshatin Miradi e Epërme. Unë jam imam në këtë fshat, andaj dua ta paraqes këtë problem, sepse ne aty me vetë iniciativë kemi rregulluar dhe kositur barin në varreza dhe kemi kryerë edhe punë tjera në interesin e publikut, andaj na intereson edhe çështja në fjalë që është një shqetësim për banorët e zonës.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky projekt publikë është trevjeçarë dhe financohet nga Ministria e Infrastrukturës, shuma e mjeteve financiare për realizimin e tij është 810,000.00€, ky përsitues janë banorët e fshatit Miradi e Epërme dhe bizneset në zonën industriale. Lënda tanë është në procedurë në Gjykatën e Apelit, por keni kujdes nëse dilni në protesta, të mos e rrokullisni ndonjë kamion me mallëra, e të thirreni në emër të banorëve të fshatit Miradi e Epërme, në emër të popullit, si e keni zakon. Në këtë punë ka patur veprime dhe ndërhyrje politike të pa arsyeshme, në mënyrë që projekti të dështon, mirëpo ne do të jemi këmbëngulës në realizimin e këtij projekti.

**Nënkryetari i Komunës:** Projekti në Rrafshina do të kryehet shumë shpejtë, mbeturinat ne po i heqim nëpër shumë zona vazhdimisht, edhe pse kjo punë nuk është e jona, por e kemi bërë shumë herë në interesin publikë të qytetarëve, ju vetë duhet t'i lajmëroni automjetet dhe personat që shihen duke hedhur mbeturina. Lidhur me projektin e rrugës në fshatin Miradi e Poshtme, pajtohem në plotëni me mendimin e Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik, se duhet të keni kujdes e të mos shkaktoni dëme me rrokullisje të ndoni kamioni, në këtë rast komuna po fajësohet pa të drejtë, ne i kemi dërguar shkresë edhe Ministrit të Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu, për vazhdimin e këtij projekti. Listën për kompensimin e vërvshimeve e keni në sistemin e thesarit dhe mund ta merrni, sepse mund ta bëni edhe ndonjë padi tjetër. Nga uji qytetarëve u janë dëmtuar shtëpitë e banimit, parketi, laminate e tjera, ne u kemi dhënë përparrësi familjeve që u ka hyrë uji brenda, në periudhën e ardhshme do të kompensohen edhe familjet tjera me më pakë dëme. Personeli mjekësorë po ikë në qendra tjera shëndetësore, kjo është e vërtetë, ne kemi kërkuar disa herë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave Puniës dhe Transfereve që të na përkrahin në shëndetësi, por kjo deri tanë nuk ka ndodhur. Brçz i pishave do të ruhet, ne e kemi bërë disa herë pastrimin e pishave, me ndërtimet pa leje do të veprojmë njëjtë sikur Ministria e Ambientit, ato që nuk i plotësojnë kriteret për legalizim, duhet të rrënohen. Do të veprojmë në kordinim me Agjensinë për Mbrojtjen e Mjedisit, nuk do të lejohen ndërtime pa leje, do të veprojmë sikur në Prevallë, nuk do të lejojmë shkatërrime si në Lazarat, do të veprojmë në kohën e diuhur. Lidhur me pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi për kompaninë që mirret me billokimin dhe zbillokimin e automjeteve, 25% e mjeteve financiare hyn në llagari të komunës, ata nuk na jepin llogari neve si komunë. Projekti përrugullimin e shiritave për q-iklistë, sipas tenderit ka kushtuar 40,000.00euro, puna është kryerë në bazë të tenderit. Ne e kemi traditë me përvite me radhë që mësuesit të shkojnë në pushim dhe këto kërkesa janë realizuar

me vite në arsim. Vendosja e kameravc është bërë në qytet dhe nëpër shkollat e qytetit, do të vazhdohet edhe nëpër disa fshatra, shumë për këtë projekt nuk është gjysmë milioni euro. Nuk duhet të theksoni gjëra të pa qëndrueshme pa fakte, ne nuk jemi në shkretirën e Saharës këtu të nderuarë, i kemi institucionet kompetente ku adresohen çështjet në bazë të faktave, e jo në bazë të fjalëve të kota në opinion. Urën në fshatin Bardh i Madh e kanë ndërtuar familja Gërguri, ne nuk e kemi obligim prejten e barit në rrugët magistrale, kjo është obligim i Ministrisë së Infrastrukturës.

### **Pika e tretë (3) - Propozim për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Tani dua të sqaroj para juve të nderuarë anëtarë të Kuvendit të Komunës, se në propozim ka ndodhur një gabim, ky ju njoftoi se ‘Propozimin për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë’, duhet të jetë me emrin e veprimtarit dhe akademikut Idriz Ajeti, i cili ka qenë edhe Kryetari i parë i Parlamentit të Republikës së Kosovës, në fillim të viteve të nëntëdhjetë, si dhe ‘Propozimin për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë, me emrin e veprimtarit të njojur në Fushë-Kosovë Haki Bajrami. Ju stoi nëse pajtoheni që diskutimet për pikën tre dhe katër të rendit të ditës, meqë janë të natyrës së njëjtë, t’i zhvillojmë së bashku, ndërsa vendimet duhet t’i marrim veç e veç. Hap diskutimin.

**Migjen Kolshi:** Unë në pikën paraprake nuk mund ta parashroi një pyetje, që njëherit është obligim i imi lidhur me vendosjen e tre busteve të heronjëve tanë, këto përmendore janë të punuar nga Shoqëria Civile me datën 22.06.2021, kjo punë është një obligim i institucionit të komunës që vjen nga viti 2020. Në parim emërtimi i shkollave nuk është në kompetencën e Kuvendit të Komunës, me Udhëzimin Administrativ 10/2008, emërtimi i shkollave fillon nga këshilli drejtues nëpër shkolla, me tre propozime, kërkesa pastaj i drejtohet Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe kjo kërkësë adresohet në Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, andaj ju nuk duhet të na futni në diskutime konkrete për emrat e respektuar të akademik Idriz Ajiteti dhe veprimtarit Haki Bajrami. Unë znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kërkoi nga ju që kjo pikë e rendit të ditës të tërhoiqet nga diskutimi, përndryshe unë e kam një propozim tjetër që anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci dhe juristi i juaj z. Hasan Gjyrevci, e njojin mirë është dëshmori Imer Shala, i cili në vitin 1995 dhe 1996, e ka zhvilluar një betejë të balacuar me Tigrat e zi, në fshatrat Baincë, Kleqkë dhe Divjakë dhe do të ishte shumë e mirë se ardhur dhe vlerë për ne, që një shkollë në Komunën tonë ta mbajë emrin e tij. Por unë kërkoi që ju të jeni transparente, ta dëgjoni juristin tuaj që e keni afër, i cili ka përvojë dhe i dinë shumë mirë procedurat, të mos na sillni për shqyrtim propozime të paligjshme në Kuvendin e Komunës, ne përvëç aktivistit Haki Bajrami i kemi edhe dy qindë persona tjérë dëshmori, martirë dhe veprimtarë të shquar për emërtimin e shkollave të reja, të cilin duhet ta bëjmë në mënyrë të unifikuar të gjithë së bashku.

**Remzi Shala:** Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës me unanimitet, e kemi bërë themelin e dy institucioneve parauniversitare arsimore në Fushë-Kosovë, të cilat tani ne propozojmë që t’i emërtojmë, me emrat

e këtyre dy veprimtarëve, ku shkolla në lagjen e Dardanisë është nderë që ta ketë emrin e Akademikut Idriz Ajeti, kuptohet ne në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim për aprovim ‘Propozimin për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë’, me emrin e veprimtarit Akademik Idriz Ajeti dhe ‘Propozimin për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë’ me emrin e veprimtarit dhe aktivistit të çështjes kombëtare Haki Bajrami. Këto vendime do të shqyrtohen dhe vlerësohen në Ministrinë përkatëse.

**Migjen Kolshi:** Unë kërkoi që këto pika të rendit të ditës të mos hidhen në votim, sepse neve si anëtarë të Kuvendit të Komunës, po na vendosni në pozitë të vështirë, pse ne mos t'i votojmë këta emra, ju e nderuara znj. Kryesuesc e Kuvendit të Komunës, po e përgatitni rendin e ditës në mënyrë të përrugulltë, çdo pikë që vjen nga Kryetari i Komunës ju e vendosni në rendin e ditës.

**Durim Hajra:** Të nderuarë/a anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, ajo që e theksoi kolegu z. Migjen Kolshi për emërtimin dhe riemërtimin e shkollave, është e saktë si procedurë, sipas nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ, procesi fillon në Këshillin drejtues të shkollës, vjen në Drejtorinë e Arsimit, pastaj njëri nga emërat dërgohen në Ministrinë e Arsimit për marrjen e pëlgjimit për emërtimin e shkollës. Me këto propozime po tentohet të vendoset politikisht, sepse ne të gjithë kemi qenë unik, sa i përket themelimit të dy institucioneve parauniversitare në Komunën e Fushë-Kosovës. Ne e kemi ngritur punën e pronësisë në të cilën është ndërtuar objekti shkollorë në lagjen e Dardanisë, pa oborrë, ky objekt arsimorë nuk i plotëson kushtet për mësim, shkolla është e tipit të mbyllur, por tani ne u pajtuam për pavarsimin e shkollës, ndërsa ju në aspektin tjetër formal, pa përbajtje, po veproni ndryshe në kundërshtim me udhëzimin administrativ, kërkesë të cilën ne nuk mund ta pranojmë. Pa hyrë në vlerësimin e emrave të propozuar për emërtimin e dy shkollave, siç e ceku edhe parafolësi im, ne kemi emra të dëshmorëve të respektuar dhe meritorë për emërtimin e shkollave tona.

**Ali Ismaili:** Unë deshta të kursehem sot nga diskutimi, por për njëzet vjetë kohë nuk po kuptohet drejtë situata jonë, pse ne duhet ta shkelim me votimin tonë Udhëzimin Administrativ, me tendencën e juaj që të na vendosni në lajthi, si keni vepruar edhe disa herë më parë, por kjo tani nuk është mirë të bëhet, sepse kemi të bëjmë me një emër të respektuar siç është Akademik Idriz Ajeti, duke theksuar se vendimi dërgohet dhe shqyrtohet, nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nëse nuk është në rregull kthehet në rishqyrtim. Për këtë çështje unë propozoi që të mbahet një diskutim publik, nuk kemi nevojë ne të mirremi me propozime të caktuara paraprakisht për emërtimin e shkollave, njërin prej të propozuarëve për emërtim të shkollës z. Hasan Ismajli e ka dajë dhe kërkon që ta votojmë, kjo punë nuk shkon kështu të nderuarë, familja ime ka dhënë kontribut për këtë shoqëri, duke filluar nga Mulla Nuhiu që të gjithë e njohim, neve familjen tonë pushteti serb na ka maltretuar, në luftën e Kosovës e kanë vrarë babën tim, edhe unë si fëmijë nëntë vjeçarë jam torturuar nga armiku ynë, me pretekstin për armë, në zonën ky tani është rruga ‘Pajazit Islami’, kinse ne i kemi marrë armën Ivicës, kemi punuar për këtë vend, si imam në edukimin fetarë e kombëtarë të popullit dhe kontributi ynë nuk po vlerësohet. Njerëz të tillë më kontribut të shquar në komunën tonë ka shumë, dëshmorë e martirë, unë mund të jap disa emra tani, por jo, sepse ne kërkojmë që të përsillen procedurat ligjore. Për shkollën në

lagjen e Apollonisë, ne e kemi ngritur dorën me synimin e vetëm se do të ndërtohet një shkollë e re për fëmijët tanë, vendimi është kërkuar të rishqyrtohet, kjo nuk është bërë, ajo pjesë ku gjindet shkolla me Planin e Ahtisarit është në territorin e Komunës së Graçanicës, por ju nuk po e dëshironi mendimin tonë si opozitë, po veproni ndryshe, duke mos e kërkuar unitetin tonë për çështjet në arsim dhe shëndetësi.

**Nënëkryetari i Komunës:** Ne shkollën e kemi ndërtuar për plotësimin e nevojave për nxënësit tanë, ju falënderojmë të gjithëve për kontributin e dhënë, shkolla pritet të jetë gati në muajin shtator dhe ju stojmë që t'i përkrahni për aprovim këto propozime, të cilat shqyrtohen dhe vlerësohen edhe nga organet më të larta të shtetit tonë. Ne kemi problem sepse nuk po rriten normat në arsim, e njëjtë vlenë edhe për personelin mjekësorë. Ne këtë punë po e bëjmë, sepse jemi të detyruar, për ta rritur presionin si komunë, për trajtimin e duhur në arsim nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave.

**Ali Ismaili:** Ju në rastin konkret, po e shkelni Udhëzimin Administrativ për emërtimin e shkollave dhe duke e hedhur në votim, po e djegni pa të drejtë emrin e respektuar të Idriz Ajitet, kërkojmë që të mos veproni në mënyrë të njëanshme.

**Driton Ademi:** E para arsimi parauniversitarë është në kompetencë të komunës, ne kemi pranuar që të hapim debat me nivelin qendror në rastin tonë për shkollat e reja, është e saktë ajo që po thuani për Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2008, lidhur me emërtimin e shkollave, por aktet e përgjithshme duhet të shikohen si hirarki e kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore, me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kompetencën për arsimin parauniversitarë e ka komuna, në këtë rast mbështetur edhe në rethanat e komunës tonë, unë së pari kërkoi që të zbatohet ligji, si akt më lartë juridik. Dhënia e tre propozimeve është një proces burokratikë dhe unë e kundërshtoi këtë pozicion që paraqitet në aspektin formal, tani edhe muaji shtatori është afër, ne duhet të veprojmë si institucione komunale, të përgatitët shkolla për nxënës.

**Sabit Bullatovci:** Qëllimi këtu është të kemi një konsultim me shkollën për procesin e emërtimit, por kjo është një dhimbje për ne, ju nuk po thuani asgjë, ne duhet të jemi të lumtur që kemi mundësi ta emërojmë shkollën tonë, me emra të respektuar të popullit tonë. Këto shkolla janë ndërtuar me mijet financiare të taksapaguesëve tanë, ju duhet të dini se Kryetari i Komunës është laik në këtë drejtim, por ai ka obligim ligjorë që të kujdeset për mbarëvajtjen e procesit arsimorë, andaj kërkon që shkollat tona pas themelimit të tyre, të emërohen me këta dy emra të propozuar. Ligjet duhet t'i përshtaten nevojave të popullatës, arsimit, shëndetësisë, është gjynah ne të diskutojmë në këtë mënyrë. Mua emrat nuk më kanë pëlqyer shumë, sepse kemi emra edhe më të mirë, unë mendoi se do të ishte nderë që shkollat tona të emërohen me emrat e figurave të njoitura si: Ibrahim Rugova dhe Adem Jashari në qendër në Fushë-Kosovë, ku ka shumë vizitorë nga e gjithë bota, sepse jemi në pjesën qendrore të vendit tonë afër kryeqytetit, unë personalisht jam për këta dy emra emblematiske, që kanë dhënë kontributin më të madh dhe të çmuar për lirinë, çlirimin dhe pavarësinë e vendit tonë.

**Migjen Kolshi:** Kjo mënyrë e komunikimit nga ana juaj i nderuari anëtar i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci, nuk është e drejtë dhe e duhur, ne i dhamë arsyetimet tona, propozimet tona dhe kërkuan reflektim nga pushteti, që të mos bëjmë shkelje në vazhdimësi me vendimet tona.

**Ali Ismaili:** Nuk pajtohem me mendimin e shprehur nga anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci, ne e kemi një përvojë në jetë dhe e njohim kontributin e qytetarëve tanë për liri dhe çlirim, vendosja e këtyre pikave në rendin e ditës është gabim, kështu po krijohet një ndarje e panevojshme, nuk po punohet për unifikimin e qëndrimeve tona dhe arritjen e konsenzusit, që është obligim i shumicës në Kuvendin e Komunës. po na futni në zjarrë neve, unë edhe një herë kërkoj që për këtë punë, ta kemi një debat publikë, para marrjes së vendimit.

**Driton Ademi:** Në aspektin procedural propozimet duhet të vijnë në Drejtorenë Komunale të Arsimit, por ne tani jemi para dy trugëve, vendimarijen dhe respektimin e ligjshmërisë, që nënkupton zbatimin e obligimeve në arsimin parauniversitarë nga komuna si institucion, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në fushën e arsimit, neve duhet të marrim këtë vendim dhe të emërtojmë këto dy shkolla të reja, që i themeluam me vendimin tonë në mbledhjen e kaluar.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë’ me emrin e akademik Idriz Ajeti.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej trembëdhjetë anëtarë të pranishëm që marrin pjesë në votim.

Në bazë të pjesëmarrjes në votim, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstaton se propozimi në fjalë nuk kalon, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

#### **Pika e katërt (4) - Propozim për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Pas sqarimeve, meqë diskutimet u zhvilluan për pikën tre dhe katër së bashku, e qiti në votim ‘Propozimin për emërtimin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë’, me emrin e veprimitarit të çështjes kombëtare Haki Bajrami.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej trembëdhjetë anëtarë të pranishëm që marrin pjesë në votim.

Në bazë të pjesëmarrjes në votim, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstaton se propozimi në fjalë nuk kalon, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

#### **Pika e pestë (5) - Propozim për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për mësimin joformal.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për mësimin joformal’, si të hyra vetjake në arsim, që destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor dhe mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal. Këto mjete financiare janë grumbulluar nga pagesat e nxënësve në xhirologarinë e komunës dhe ne duhet ta marrim një vendim për shpenzimin e tyre, meqë shkolla nuk ka xhirologari të vetën. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për mësimin joformal’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Propozimin për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare për mësimin joformal’ dhe mori:

#### V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 495, të datës 17.06.2021, për shfrytëzimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 14,844.94€, si të hyra vetjake në arsim, të destinuara për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor dhe mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal, të cilat alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike ‘Minatori’, kodi i programit Nr. 94231, shuma 5,567.64€, në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike ‘Hoxhë Kadri Prishtina’, kod i programit Nr. 94232, shuma 9,277.30€.

#### Pika e gjashtë (6) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për shërimin shëndctësorë të Rajana Berisha.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për shërimin shëndctësorë të Rajana Berisha’. Hap diskutimin.

**Ali Ismaili:** Ne në raste të tilla që janë shqyrtuar në Kuvendin e Komunës, kemi ndarë shuma të mjeteve financiare deri në 9,000.00€, ky rast është pak më i ndieshëm, sepse kemi të bëjmë më një fëmijë, ju e dini se kemi ndarë shuma më të mëdha, andaj propozoi që edhe në këtë rast të shkojmë ne shumën maksimale. Po ashtu, kërkoi që njerëzit, që kanë sëmundje të rënda leukemi, kancer dhe janë përfitues nga lista e subvencioneve, t’iu ndahen mjetet financiare nga subvencionet, sepse ne kemi kërkesa të personave në nevojë, që kërkojnë nga ne si anëtar të Kuvendit të Komunës, që të ndikojmë që këto mjete financiare të transferohen në llogaritë e tyre, sa më shpejtë që të jetë e mundur.

**Remzi Shala:** Rasti në fjalë është një ndër rastet më të kompletuara, që ka ardhur për shqyrtim dhe marrjen e vendimit, për përkrahje financiare në shërim shëndetësorë në Kuvendin e Komunës, të mos keqëkupto hemi ne këtu, nuk jemi kundër rritjes së shumës për vajzën e vogël, por mundësitet financiare janë të limituara dhe në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë që të aprovohet shuma e mjeteve financiare prej: 5,000.00€, ashtu si është propozuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në konsultim paraprakë me Drejtoren e Financave dhë Buxhetit.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€ për shërimin shëndetësorë të Rajana Berisha’.

U votua unanimitisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€ për shërimin shëndetësorë të Rajana Berisha’ dhe mori:

#### V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Shkelzen Berisha nga fshati Graboc i Poshtëm, me destinim për të ndihmuar në shërimin

shëndetësorë dhe trajtimin e vajzës së tij Rajana Berisha, e cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Neuroblastoma.

**Pikë e shtatë (7) - Propozim për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë’, sistemimi i nxënësve do të bëhet për shkollën ‘Mihal Grameno’ dhe shkollat e reja në lagjen e Dardanisë dhe Apollonisë, ndërsa për shkollat ‘Selman Riza’ dhe ‘Daut Bogujevci’, nuk do të kemi ndryshime edhe për një vitë shkollorë, andaj mbetet ndarja e caktuar nga grapi i kaluar punues i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës. Tani në këtë Grup Punues nga Kuvendi i Komunës do të jenë pesë anëtarë, stoq përsaqësuesit e subjekteve politike, që t’i jasin propozimet e tyre për këtë Grup Punues. Hap diskutimin.

**Ali Ismaili:** Të nderuarë, ju në këtë rast duke po thirreni në gjithëpërfshirje në përsaqësim të Grupit Punues, në fakt po e bëni të kundërtën e saj, duke eliminuar shumicën e subjekteve të vogla politike AAK, AKR, Nisma Socialdemokrate dhe Partinë e Drejtësisë nga pjesëmarrja në këtë punë, nuk kompletohen Grupet Punuese me veprime të njëanshme.

**Remzi Shala:** Në emër të Grupit Punues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, i propozojmë znj. Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës dhe znj. Arjeta Jashari.

**Durim Hajra:** Unë pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili, se ky grup punues duhet të jetë gjithëpërfshirës, por shrima vendos për përbërjen e Grupit Punues. Në emër të Grupit Punues të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, e propozojmë znj. Eglantina Azemi.

**Arjana Zogjani:** Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, e propozojmë znj. Aida Alimi.

**Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete:** Përshëndes të prabnishmit në mbledhje. Për anëtarë të Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, unë e propozoi z. Ali Ismaili.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë’, në përbërje prej trembhëjtë anëtarëve si vijon: Vjollca Konjusha, Arjeta Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Ali Ismaili, Lindita Jashanica Rahmani, Ismet Gashi, Sadri Emini, Mimoza Kryeziu, Sherife Aliqkaj, Remzie Bogujevci, Sabri Xhigoli dhe Antigona Sahiti.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota ‘për’, asnjë ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve

sipas rrugëve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë', në përbërje prej trembëdhjetë anëtarëve si vijon: Vjollca Konjusha, Arjeta Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Ali Ismaili, Lindita Jashanica Rrahmani, Ismet Gashi, Sadri Emini, Mimoza Kryeziu, Sherife Aliqkaj, Remzie Bogujevci, Sabri Xhigoli dhe Antigona Sahiti dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve dhe regjistrimin e tyre në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, për vitin shkollor 2021/2022, në përbërje prej trembëdhjetë anëtarëve si vijon:
  - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
  - 1.2 Arjeta Jashari - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
  - 1.3 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare;
  - 1.4 Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
  - 1.5 Ali Ismaili - Përfaqësues i Partisë së Drejtësisë, anëtar;
  - 1.6 Lindita Jashanica Rrahmani - Drejtor e Drejtorisë së Arsimit, anëtare;
  - 1.7 Ismet Gashi - Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' anëtar;
  - 1.8 Sadri Emini - Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e 'Dardanisë' anëtar;
  - 1.9 Mimoza Kryeziu - Përfaqësuese e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët në lagjen e 'Apollonisë' anëtar;
  - 1.10 Sherife Aliqkaj - Përfaqësuese e Këshillit të Prindërve, anëtare;
  - 1.11 Remzie Bogujevci - Drejtor e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' anëtare;
  - 1.12 Sabri Xhigoli - Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', anëtar;
  - 1.13 Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban, anëtare.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pikë një (1) e vendimit, është caktimi i rrugëve në qytetin e Fushë-Kosovës për vijueshmérinë e nxënësve në procesin edukativ-arsimorë në shkollën 'Mihal Grameno', në shkollën në lagjen e Dardanisë dhe shkollën në lagjen e Apollonisë, për vitin shkollorë 2021/2022 dhe vitet e ardhshme shkollore.
3. Ndarma e caktuar nga Grupi Punues i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës për shkollat: 'Selman Riza' dhe 'Daut Bogujevci' mbetet e njëjtë edhe për vitin shkollorë 2021-2022 deri në rishqyrtimin e saj.

#### Pika e tetë (8) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova'.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova', të nderuar/a, anëtar/e të Kuvendit të Komunës, rekomandimi i dalur nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, është që të përkrahet klub i futbollit me shumën e mjeteve financiare, 25 mijë plus 25 mijë euro, për dy vite buxhetore, që nënkupton krijimin e kushteve për klubin e qytetit tonë dhe mundëson, garimin e tij në kampionatin e fubollit për edicionin 2021-2022. Hap diskutimin.

**Remzi Shala:** Klubi i Futbollit 'Fushë-Kosova', është klub i më masovik sportiv në komunën tonë, ky i zhvillojnë aktitivitet sportive rinia jonë dhe meriton të përkrahet, me mundësitë buxhetore që

i ka komuna jonë, shpërndarja e shumës së mjeteve financiare, do të bëhet në dy vite buxhetore, andaj edhe mund të realizohet nga komuna. Klubi këtë vitë ka arritur rezultate dhe suksese në gara kampionale, sepse është inkuadruar në Ligën e Parë të Futbollit dhe aty shpenzimet janë më të mëdha, ju po i shihni shumat që nevojiten pör funzionim një vjeçarë të klubit, e keni një pasqyrë para vetës. Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë që Klubi i Futbollit ‘Fushë-Kosova’ të përkrahet me mjete financiare, sipas rekomandimit të dalur nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Migjen Kolshi:** Në parim, ne jemi për aprovimin e shumës së propozuar për përkrahjen financiare të Klubit të Futbollit ‘Fushë-Kosova’, për edicionin e ardhshëm të garave kampionale. Më pëlqen fakti, tani që disa shpenzime i kanë paraparë që të realizohen nga donatorët e mundshëm, sepse këtë punë tani e mundëson edhe ‘Ligji për sponzorizimin e sportit’. Ne kërkojmë llogari për mjetet e ndara financiare për klubin e futbollit, përmes raportimit të shpenzimeve, raportime financiare të cilat i kemi kërkuar edhe në të kaluarën, por nuk i kemi marrë.

**Durim Hajra:** Në parim sporti duhet të përkrahet, por edhe të kërkohet llogari për mjetet e ndara financiare. Tani jemi në një periudhë të vështirë si shoqëri në përgjithësi, është kohë e pandemisë, klubet sportive kanë vështirësi në funksionimin e tyre. Të gjitha klubet sportive funksionojnë si Organizata Jo Qeveritare dhe duhet të raportojnë shpenzimet e tyre, ne kemi ndarë mjete financiare për Klubin e Futbollit edhe më herët, por nuk e kemi patur asnjëherë ndonjë raport financiarë për shpenzimin e tyre. Mua më intereson të dijë edhe lidhur me statusin juridikë të pronës së Stadiumit të Futbollit ‘Fushë-Kosova’, nga Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport.

**Udhëheqësi i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport:** Pëershëndes të pranishmit në mbledhje. Raporti financiarë për shpenzimet dorëzohet në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport. Klubet tona funksionojnë si Organizata Jo Qeveritare dhe ne i përkrahim përmes subvencioneve të gjitha, në përputhje me mundësitet buxhetore. Për ndryshimin e statusit juridik të klubeve sportive janë dy mënyra, shndërrimi i tyre në klube private të sportit, ku duhet një garancion financiarë prej 150,000.00€, që nuk ka mundësi ta plotëson asnjë klub dhe krijimi i shoqërive aksionare, me aksione, që po ashtu është e vështirë për klubet tona sportive, të cilat kanë shumë vështirësi përfunksionim. Pronën në Kosovë nga klubet e futbollit e ka rregulluar vetëm KF ‘KEK-u’ nga Obiliqi, ne kemi bërë kërkësë përfregullimin e kësaj çështje, ju të gjithë jeni të njojur me vendimin e marrë nga ish/Kryeministri z. Ramush Haradinaj për kthimin e pronave shoqërore, në pronësi të komunave, por ky vendim është dërguar në Gjykatën Kushtetuese nga ish/Presidenti i Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi dhe është pezulluar zbatimi i tij. Ne i kemi në buxhet vetëm 35,000.00€ dhe me këto mjete financiare, i subvencionojmë brenda një viti buxhetorë njëzet ë dy klube sportive.

**Sabit Bullatovci:** Në vitin 1984 është formuar dhe ka funksionuar mirë Klubi i Futbollit ‘Besa’ nga fshati Miradi e Poshtme, fusha në fshatin tonë është e mrekullueshme, unë e stoi tani gjygiëtarin ndërkombetare të futbollit dhe Drejtorin tonë për Kulturë, Rini dhe Sportit, që e njeh mirë rëndësinë e aktivitetit sportive përininë tonë, që të bëhen investime të mirëfillta publike në këtë fushë të futbollit. Këtu në vitet e nëntëdhjetë dhe në vitin 2000 dhe 2001, kanë stërvititur klubet tona më të njoitura si: KF ‘Prishtina’, KF ‘Fushë-Kosova’, e klube tjera. Një rrëthim i fushës që

është bërë, është për turp, aty janë vendosur thupra thane, jo material i metaltë, investimet publike në infrastrukturën e sportit duhet të monitorohen nga komuna jonë.

**Driton Ademi:** Tani lidhur me përkrahjen financiare të Klubit të Futbollit ‘Fushë-Kosova’ duhet të shikohet aspekti financiarë i planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore, në mënyrë që të mos jemi jashtë procedurave të lejuara.

**Mirvete Gërguri:** Në komunën tonë pyes, a ekziston ndonjë klub i futbollit përfshira, nëse jo, pse nuk punohet në këtë drejtim.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin përkrahjen financiare të Klubit të Futbollit ‘Fushë-Kosova’, në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej: 50,000.00€ përfshira buxhetore, nga 25 mijë euro.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Propozimin përkrahjen financiare të Klubit të Futbollit ‘Fushë-Kosova’, në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej: 50,000.00€ përfshira buxhetore, nga 25 mijë euro dhe mori:

#### V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare përfshira Klubin e Futbollit “Fushë-Kosova”, në shumë të përgjithshme prej: 50,000.00€, me destinim përfshira mbulimin e shpenzimeve përfshira pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës përfshira vitin garues 2021-2022, si vijon:
  - 1.1 Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 25,000.00€, në vitin buxhetor 2021, do të shërbejë klubit të futbollit përfshira mbulimin e shpenzimeve, në sezonin vjeshtorë të garave kampionale futbollistike dhe
  - 1.2 Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 25,000.00€, në vitin e ardhshëm buxhetor 2022, do të shërbejë klubit të futbollit përfshira mbulimin e shpenzimeve, përfshira sezonin pranëverorë të garave kampionale futbollistike.

#### Pika e nëntë (9) - Propozim përlirim i subjekteve asariste nga taksa komunale përzgjatjen e orarit të punës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi për shqyrtim ‘Propozimin përlirim i subjekteve asariste nga taksa komunale përzgjatjen e orarit të punës’, ftoj propozuesin që ta merrë fjalën përsqarime.

**Illir Hasani:** Propozimi ka të bëjë me marrjen e një vendimi përdryshim tek ‘Rregullorja përtarifa ngarkesa dhe gjoba komunale’, me karakter të përkohshëm përlirim nga pagesa të bizneseve tonë, që paguajnë përfshira një orë punë pas orës 23:00h, shumë e mjeteve financiare prej: 25.00€, e cila shumë në këtë kohë të pandemisë është e lartë, meqë bizneset kanë shumë vështirësi, në operimin e tyre ekonomikë dhe asaristë, andaj në fillim të sezonës së pushimeve dhe ardhjes së mërgimtarëve, ne duhet t'i përkrahim bizneset ta marrim këtë vendim me validitet nga data 01 korrik deri me 31 dhjetor 2021.

**Migjen Kolshi:** Ne në parim unë jam që të përkrahen bizneset në kohë të pandemisë sepse kanë vështirësi në funksionim, por unë në rastin konkret kam konflikt të interest dhe nuk do të marrë pjesë në votim, sepse këtu hyn edhe bizneset, restoranet si janë sallat e dasmave.

**Durim Hajra:** Kjo punë duhet të rregullohet në aspektin ligjor me ‘Rregulloren për pagesat e taksave komunale’, e jo kështu. Duhet ta kemi parasysh procedurën që e ndjekim.

**Mehdi Lahu:** Ne tani në parim jemi për përkrahjen e biznescve, por në rastin konkret nuk e kemi të specifikuar mënyren e marres së vendimit, sepse duhet ta kemi parasysh se në vendet e përendimit, klubet e natës dhe diskotekat paguajnë taksa të larta, nuk funksionojnë si të gjitha bizneset tjera që janë të dëmtuara, në aspektin e operimit ekonomikë të tyre.

**Driton Ademi:** Ne të gjitha subjektet asariste i kemi liruar nga taksat komunale, për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike dhe asariste në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2021, tani komunat do të ndihmohen edhe me grantin e katërt nga Qeveria e Kosovës. Për zgjatjen e orarit të punës ka rregulla specifike, për bizneset e caktuara që nuk janë në kompetencën tonë.

**Drejtori për Zhvillim Ekonomik:** Unë e mirëpres përkrahjen e bizneseve, por kjo punë duhet të jetë e specifikuar qartë nga propozuesi, sepse këtu ka rregulla të njohur për operimin e tyre pas orës 23:00h. Për raste të tillë kemi pak kërkesa, gjithsej tridhjetë për katër vite dhe të dalat për biznese nga këto taksa komunale, nuk janë të mëdha sillen nga treqindë deri në katërqindë euro.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për lirimin e subjekteve asariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri me 31.12.2021’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Propozimin për lirimin e subjekteve asariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri me 31.12.2021’ dhë mori:

#### V E N D I M

1. Për aprovimin e propozimit për lirimin e subjekteve asariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri me 31.12.2021.
2. Subjektet asariste që e zhillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, lirimin nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, do ta realizojnë përmes kërkesës në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, për kohën e zgjatur pas orës 23:00h.

#### Pika e dhjetë (10) - Të ndryshme.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** E kemi pikën ‘Të ndryshme’, sfoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

**Ali Ismaili:** Kërkoi sqarime nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, pse shumat e ndara për shkollat tona, për organizimin e udhëtimeve të personelit arsimorë nuk janë të njëjtë, po ashtu nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, e kërkoijmë listën e ndarjes së subvencioneve për 22 klubet sportive në Komunën e Fushë-Kosovës. Unë për tetë vite me radhë, nuk kam shkuar asnjë herë me anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës nëpër organizime të tillë në Shqipëri, në mandatin e kaluar ka udhëtuar me anëtarët tjerë të Kuvendit të

Komunës, anëtarja e Kuvendit nga Partia e Drejtësisë znj. Fitore Simnica. Unë vetëm po them, se duhet të veproni me standarde të njëjta për të gjithë, si dhe shumat të jenë të arsyeshme për ta mbrojtur buxhetin e komunës. Po ashtu në udhëtime të tilla, shkojnë edhe pensionistët e komunës tonë, ndërsa ne nuk e kemi asnjë raportim financiarë për këto shpenzime.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës:** Kuvend i Komunës mjetet tona financiare nga kategoria e mallërave dhe shërbimeve, i kemi shfrytëzuar për udhëtime zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe për Grupet Punuese për hartimin e Rregulloreve Komunale.

**Driton Ademi:** Unë them se këto udhëtime nuk janë zyrtare dhe nuk duhet të ndodhin, kjo punë nuk duhet të bëhet, sepse nuk e meritojnë të shkojnë askush me mjetet financiare të taksapaguesve.

**Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete:** Unë kërkoi nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedisit, që ta bënë rregullimin e ndriçimit publik në lagjen 028 dhe 029. Ne lagjen tonë ka qenë një memorandum I nënshkruar nga Qeveria e udhëhequr nga ish/Kryeministri z. Avdullah Hoti, por puna nuk ka filluar.

**Nënkyetari i Komunës:** Memorandumet e vitit të kaluar për investime publike nga Qeveria e Kosovës janë anuluar. Vizitat e arsimtarëve në Republikën e Shqipërisë, janë shndërruar në traditë me vite të tëra dhe shkollat tona përkrahën, sipas numrit të arsimtarëve, sepse ka shkolla me personel më të madh arsimorë.

**Ali Ismaili:** Tani meqë shumica e shkollave, shoqatat e pensionistëve dhe të tjerë, kanë shkuar në udhëtime në Republikën e Shqipërisë dhe në Ohër e Strugë të Maqedonisë së Veriut, unë propozoi që në fund të mandatit tonë zgjedhor edhe ne anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, ta bëjnë një vizitë të tillë, meqë ne e aprovojmë edhe buxhetin e komunës, andaj si organi më i lartë përsaqësues, mund ta realizojmë një vizitë të tillë, sikur ka ndodhur edhe në vitet e kaluara. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për lejimin e vizitës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë’. U votua me: shtatëmbëdhjetë vota ‘për’, një ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për lejimin e vizitës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë’ dhe mori:

#### V E N D I M

Për lejimin e vizitës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 13:35 minuta.**

**Procesmbajtës**

Hasan Gjyreçi

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës**

Vjollca Konjusha